Kronikë

Qëlloi me çifte kuajt në Llogara, nis hetimi ndaj 55-vjeçarit, i sekuestrohet edhe arma

Ngjarja e rëndë u regjistrua një ditë më parë. Burimet thanë se autorët mund të jenë gjahtarë të paligjshëm ose persona të përfshirë në konflikte për konkurrencë, ndërmjet guidave turistike.

■ Vlorë/ Krim monstruoz, qëllohet me çifte tufa e kuajve në Llogara! Shkak dyshohet konkurrenca mes pronarëve të guidave

Kali i qëlluar me çifte në Llogara

Redaksia
9 Gusht, 12:44 | Përditesimi: 9 Gusht, 12:47

Share

Policia e Vlorës ka identifikuar autorin e dyshuar që ka qëlluar me çifte ndaj kuajve në zonën e Llogarasë në Vlorë.

Kështu, uniformat blu kanë nisur hetimet në gjendje të lirë ndaj 55-vjeçarit me iniciale S.M., nga Orikumi.

Këtij të fundit iu sekuestruar edhe një çifte të cilën e posedon, për ekzaminime të mëtejshme.

LEXO EDHE:
Lufta me flakët në Livinë të Finiqit, Report Tv ndjek operacionin e evakuimit të të moshuarve

Policia thotë se nga të shtënat me armë gjahu është dëmtuar vetëm një kal.

Ngjarja e rëndë u regjistrua një ditë më parë. Burimet thanë se autorët mund të jenë gjahtarë të paligjshëm ose persona të përfshirë në konflikte për konkurrencë, ndërmjet guidave turistike.

Njoftimi i Policisë së Vlorës:

Në vijim të dokumentimit të plotë për rastin e referuar në Prokurori, për veprën penale "Keqtrajtimi i kafshëve", ku në territorin e parkut të Llogarasë, fillimisht dyshohej se ishin dëmtuar dy kuaj të shtetasit K. K., 46 vjeç, por nga verifikimet rezultoi se ishte dëmtuar njëri prej tyre, të cilit i ishin shkaktuar disa dëmtime nga armë gjahu, specialistët për Hetimin e Krimeve në Stacionin e Policisë Orikum kanë bërë të mundur identifikimin e autorit të dyshuar dhe nisjen e procedimit penal në ngarkim të tij, konkretisht ndaj shtetasit S. M., 55 vjeç, banues në Orikum. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua, për ekzaminime të mëtejshme, edhe një armë gjahu në pronësi të shtetasit S. M.

V.GJ /Shqiptarja.com

TAG: Vlorë kuajt vlorë llogara

Komento

Komente

Mario: 09/08/2025 15:38
Po 4 kuajt e ngordhur, apo ata nuk quhen?
Përgjigju

Elbasanliu: 09/08/2025 13:24
Po pse në gjëndje të lirë?? Mereni me dhun dhe futeni mbrënda. Ky është më kriminel se ai që vret njerëz. Kafshët jan të pa fashëme
Përgjigju

Xxxxx: 09/08/2025 14:29
Mori paret prokurori qe ta mbyllim ceshtjen..shtet leshi

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
A po i liron hapësirat publike aksioni i qeverisë?
7 Gusht, 10:03
Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Zjarri në Livinë të Finiqit, Ministria e Mbrojtjes: Evitohet rreziku për banesat
9 Gusht, 12:09

Përplasen 3 makina në Vlorë, plagosen 2 persona, njëri prej tyre fëmijë
9 Gusht, 11:12

7 vatra zjarri aktive në vend, problem situata në Finiq, shmanget rreziku për banesat në fshatin Livinë
9 Gusht, 09:25

Fluks udhëtarësh në portin e Vlorës/ 1019 pasagjerë e 267 automjete mbërrijnë me traget nga Brindisi, pritet rritje gjatë javës së dytë të gushtit
9 Gusht, 08:45

Lirimi i hapësirave publike në Vlorë, IKMT ndërhyn për të shembur një objekt në Radhimë (VIDEO)
8 Gusht, 15:14

I humbi të vëllait në Dhërmi, 27-vjeçari nga Tirana kthehet në banesë pas një jave 'pa gjurmë'!
8 Gusht, 11:48

Himarë/ Turistja nga Gjermania vjen për pushime, por i vjedhin paratë në vilën me qira në Palasë!
8 Gusht, 11:38

Vlorë/ 'Tokë e xanum' në zonën e mbrojtur të Vjosës, 54-vjeçari 'privatizon' pyllin e Poros dhe e kthen në plantacion ullinjsh! Policia e merr nën akuzë
8 Gusht, 11:05

Policia e Vlorës për hetimet e zjarrit te fusha e mbetjeve: Dyshohet se është aksidental, u dëmtua eskavatori i Bashkisë!
8 Gusht, 10:57

Vlorë/ Krim monstruoz, qëllohet me çifte tufa e kuajve në Llogara! Shkak dyshohet konkurrenca mes pronarëve të guidave
8 Gusht, 09:25

8 zjarre aktive në disa qarqe të vendit, vijojnë flakët në Tragjas të Vlorës, Mallakastër, Bërzhitë e Gjirokastër! Ndihmuan tre avionë nga Suedia e Kroacia
8 Gusht, 08:43

Vlorë/ U hodh me kokë nga shkëmbi te 'Gjiri i Gramës', plagoset turisti 12-vjeçar! Policia Kufitare i vjen në ndihmë dhe e shpëton (VIDEO)
7 Gusht, 17:15

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje